

VIII QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

NOCIONET KRYESORE:

Qeveria; kabineti; ministrat; kryetari i qeverisë; qeveria politike homogjene njëpartiake; qeveria e kualicionit; qeveria e koncentracionit; qeveria e ekspertëve; qeveria administrative; qeveria e “ bashkimit popullor ” (“Qeveria demokratike”); zbatimi i ligjeve; mandati për përbërjen e Qeverisë; çështja e mocionit të votëbesimit të Qeverisë.

PYETJE:

1. Çfarë lloje qeverish ekzistojnë?
2. Si është i përcaktuar inkopatibiliteti i funksionit ministëror në Kushtetutën e RM-së?
3. Çka përfshin kompetenca e qeverisë së RM-së që t’i zbatojë aktet e Kuvendit?
4. Çfarë kompetencash ka Qeveria e RM-së në kompetencën normative të Kuvendit?
5. Çfarë kompetencash ka qeveria e RM-së në realizimin e politikës së jashtme?
6. Si rrjedh procedura për zgjedhjen e Qeverisë së RM-së?
7. Në cilat raste Qeverisë së RM-së i ndërpritet mandati?
8. Çfarë marrëdhëniesh ekzistojnë ndërmjet shefit të shtetit dhe Qeverisë – horizontale ose vertikale?

1. Kuptimi dhe llojet e qeverive

Qeveria është organ i pushtetit ekzekutiv i përbërë nga ministrat-autoritetet e disa resorëve administrativë (minsitritë) dhe nga persona të tjerë, të cilët sipas procedurës kushtetuese të caktuar dhe në bazë të plotësimit të kushteve të përcaktuara me kushtetutë, bëhen anëtarë të Qeverisë. Në të vërtetë, ky është në një farë mënyre definicion i përgjithshëm dhe jo precizë, por kjo është pasojë e domosdoshme e natyrës dhe esencës së këtij organi në vende të ndryshme. Për përcaktimin sa më preciz të qeverisë hyjnë në lojë dallimi i disa elementeve, siç janë kuptimi dhe qëllimi i ekzistimit të saj, përbërja dhe kompetencat e saja.

Qeveria, si organ, e gjallëron idenë e unitetit të administratës shtetërore, gjithashtu qeveria debaton edhe për çështjet e politikës së përgjithshme dhe e përcakton drejtimin e politikës shtetërore. Roli i qeverisë (kabinetit) me kalimin e kohës është ndryshuar, në këtë mënyrë, organi që ka ekzistuar si organ këshilldhënës i mbretit, sot pozicionohet në vend qendror dhe ka rol udhëheqës në krijimin dhe udhëheqjen e politikës.

Qeveria si organ gjendet edhe me emërtime të tjera si ç'janë Këshilli ministëror, Këshilli shtetëror; në disa vende bëhet dallimi ndërmjet qeverisë si organ më i lartë dhe kabinetit si organ më i ngushtë, por mund të gjendet edhe dallimi ndërmjet Këshillit ministëror (kur me të kryeson shefi i shtetit) dhe Këshillit të kabinetit (kur me të kryeson kryetari i Këshillit ministëror).

Dallimi ndërmjet *qeverisë dhe kabinetit* të ne nuk ekziston. Të dy termet përdoren për të treguar idenë që në Britaninë e Madhe quhet kabinet. Në bazë të kësaj ideje në tekstin në vijim do ta përdorim termin qeveri (si sinonim i kabinetit).

Qeveria është e përbërë nga ministrat (sekretarët shtetërorë, sekretarët) të cilët janë në krye të një ministrie të caktuar (organi odministrativ) ose janë pa resor, ndërsa në krye të qeverisë gjendet kryeministri (ministër i parë, kryetar i qeverisë). Fjala ministër rrjedh nga fjala latine *minister*, që do të thotë shërbim.

Në varësi të (jo) përkatësisë partiake të ministrave, është i mundur dallimi i disa llojeve të qeverive:

1. qeveria homogjene njëpartiake;
2. qeveria e kualicionit – e formuar nga kualicioni i partive politike e cila ka shumicën në parlament;
3. qeveria e koncentracionit – e përbërë nga përfaqësues të të gjitha partive në parlament (në të shumtën e rasteve formohet në situata të jashtëzakonshme, për arsye të vendimmarrjes me konsensus politik);
4. qeveria e funksionarëve – e përbërë nga funksionarë të cilët marri pozicionet më të larta në hierarkinë e administratës shtetërore, të cilët për shkak të pozicionit të tillë nuk mund të jenë anëtarë të partive politike (formohet në kushte të krizave parlamentare, kur asnjë parti

politike nuk ka shumicë në parlament, nuk mund të formohet qeveri partiake, kurse koalicionet bien);

5. qeveria e ekspertëve – e përbërë nga ekspertë, kompetentë, e jo nga pjesëtarë politik (nga qeveria e funksionarëve dallohet nga fakti se vijnë si pasojë e angazhimit të vetëdijshëm të shumicës parlamentare në mënyrë që të zgjidhen personat më kompetentë në qeveri, e jo si pasojë e krizës parlamentare dhe ajo ka legjitimitet demokratik);
6. qeveria e “ bashkimit popullor ”, “ bashkimit demokratik”, “ bashkimit qytetar ” – formohet nga personalitetet më kompetentë të vendit të cilët janë politikisht neutral, me synim nxjerrjen e vendit nga kriza.

Imanente e sistemeve parlamentare dhe të përziera në kushte normale qeveria politike është, dhe atë qeveria homogjene ose qeveria e koalicionit. “ Qeveritë neutrale ” paraqesin përjashtim që paraqiten në situata të caktuara.

Faktori më domethënës për mbijetesën e një qeverie është që ajo të ketë pas vete shumicën parlamentare, për arsye se parlamenti është ai që e zgjedh ose e miraton qeverinë dhe para të cilit ajo është përgjegjëse, përkatësisht parlamenti “ disponon me jetën ose vdekjen e qeverisë ”. Roli i shefit të shtetit në formimin e qeverisë në rastet e shumta është formal, në fakt shefi i shtetit ia beson mandatin për formimin e qeverisë udhëheqësit të asaj partie që ka shumicën ose mund ta sigurojë atë shumicë. Vetëm në situata kontestuese rreth asaj se kush është lideri ose cili liderë ka shumicën në parlament, roli i shefit të shtetit në caktimin e mandatarit për përbërjen e qeverisë mund të jetë vendimtar.

2. Pozita dhe përbërja e Qeverisë në Republikën e Maqedonisë

Qeveria është bartës i pushtetit ekzekutiv. Atë e përbëjnë *kryetari dhe ministrat*.

Kryetari i Qeverisë udhëheq me veprimtarinë e Qeverisë, përgjigjet për veprimtarinë e saj dhe e drejton veprimtarinë e Qeverisë në përgjithësi dhe të anëtarëve të saj, në pajtim me përcaktimet programore dhe objektivat që ajo i përcakton. Kryetari i Qeverisë i nënshkruan urdhëresat dhe aktet që i sjell Qeveria dhe kujdeset për zbatimin e tyre.

Anëtarët e Qeverisë kanë të drejtë dhe detyrim që të marrin pjesë në punën e Qeverisë; të ngrenë iniciativë për përgatitjen e ligjeve dhe akteve të tjera për propozimin e të cilave është kompetente Qeveria, të urdhëresave dhe akteve të tjera që i sjell Qeveria dhe për përcaktimin e objektivave dhe qëndrimeve etj. Anëtarët e Qeverisë që është caktuar të marrë pjesë në punën e organeve dhe komisioneve të tjera, është i detyruar të veprojë sipas autorizimeve, objektivave dhe qëndrimeve të Qeverisë.

Ministrat udhëheqin në mënyrë të pavarur me ministratë për të cilat janë zgjedhur e përcjellin dhe janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera.

Për përcaktimin e pozicionit të qeverisë është e rëndësishme edhe çështja e *inkompatibilitetit* të funksionit të ministrave dhe të deputetëve, që në vende të ndryshme është rregulluar në mënyra të ndryshme. Në disa vende (për shembull, në Britaninë e Madhe) anëtarët e kabinetit domosdo duhet të jenë edhe anëtarë të parlamentit – deputetë (qeveria përfaqësuese), në vende të tjera (për shembull, në Serbi) nuk ekziston rregull për përkatësinë e detyrueshme parlamentare të ministrave, as që ekziston ndonjë ndalesë e tillë (qeveria e përzier) dhe në vende të treta (për shembull në Francë) ekziston inkompatibiliteti ndërmjet funksionit ministër dhe deputet.

Në lidhje me këtë çështje ekzistojnë mendime të ndryshme. Për shembull, ka mendime se kuvendi do ta arrijë shkallën e përsosmërisë që në përgjithësi mund të arrihet në përbërjen kuvendare, vetëm atëherë kur edhe ministrat në zgjedhjet kombëtare do të bëhen anëtarë të kuvendit. Duke u bazuar në atë se anëtarët anglez të qeverisë janë deputet, kabineti anglezë nuk është gjë tjetër për veç një këshilli parlamentar. Nga ana tjetër, ka mendime se shkaqet për krizat e shpeshta të qeverisë Franceze janë edhe “ garat e deputetëve për karriget ministërore ”, për këtë arsye në Kushtetutën Franceze në vitin 1958 është futur rregulli për inkompatibilitet. Këtij arsyetimi praktik mund t’i shtohet edhe arsyetimi teorik sipas së cilit nuk mund “ që në të njëjtën kohë të jeshë kontrollues dhe i kontrolluar ”.

Kushtetuta e RM-së e aplikon inkompatibilitetin e funksionit kryetari i Qeverisë me ushtrimin e profesioneve dhe funksioneve të tjera publike.

Për pozicionin e Qeverisë, e rëndësishme është edhe e drejta e *imunitetit* të kryetarit të Qeverisë dhe të ministrave. Për imunitetin e tyre vendos Qeveria.

Kryetari i Qeverisë gjithashtu edhe ministrat nuk i nënshtrohen obligimit që të marrin pjesë në forcat e armatosura.

Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë në kompetencat e saj, Qeveria punon dhe vendos nëse në mbledhje marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të saj. Mbledhjet e Qeverisë rregullisht i thërret kryetari i Qeverisë në bazë të iniciativës së tij ose sipas kërkesës së më pak të 1/3 të anëtarëve të Qeverisë, por mund edhe sipas kërkesës së ministrave të njërit nga partnerët e koalicionit¹.

Në mbledhjet e saja, Qeveria vendos me shumicë votash nga anëtarët e Qeverisë. Në rastet kur në mbledhjen e Qeverisë gjatë votimit fitohet numër i barabartë votash, atëherë si i aprovuar merret vendimi për të cilin ka votuar kryetari i Qeverisë.

Qeveria mund të vendosë edhe me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Qeverisë, kur ndërmerr masa urgjente për realizimin efikas të sigurimit të shtetit dhe zbatimin e përgatitjeve për mbrojtje dhe në rrethana të tjera të jashtëzakonshme. Anëtari i Qeverisë i cili për shkaqe të arsyeshme nuk ka marrë

¹ Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, “ Gazeta zyrtare e RM-së ”, nr. 59/2000.

pjesë në atë mbledhje, mund të thirrë mbledhje të re të Qeverisë në një afat prej 24 orësh që nga mbajtja e mbledhjes paraprake, në të cilën do të debatohet dhe do të vendoset mbi çështjet e parashtruara.

3. Kompetenca e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Qeveri e RM-së ka një numër të madh kompetencash të karakterit të ndryshëm. Megjithatë, kompetencat mund t'i klasifikojmë në disa grupe:

1. *Ekzekutimi i ligjeve dhe i normave të tjera të Kuvendit.* Kjo është një e drejtë që konsiderohet si kompetencë më imanente e Qeverisë në të gjitha vendet. Në të njëjtën kohë, dhe definimi më i thjeshtë i Qeverisë dhe pushtetit ekzekutiv në përgjithësi është nëpërmjet funksionit të saj t'i ekzekutojë ligjet dhe aktet e tjera të kuvendit. Përcaktimet tradicionale të pushtetit ekzekutiv, si degë e pushtetit shtetëror e cila merret me *ekzekutimin e ligjeve* dhe akteve të tjera të sjella nga pushteti legjislativ, paraqesin në njëfarë mënyre klishe. Ky është definicioni që haset në shumë tekste dhe punime, por që ka një mori mangësish. Sipas këtij definimi, pushteti legjislativ i sjell ligjet, ndërsa pushteti ekzekutiv i ekzekuton ato. Të ngjashme janë edhe definimet sipas së cilave pushteti legjislativ mendon, ndërsa pushteti ekzekutiv vepron.

Kështu Zhan Zhak Ruso është i mendimit se çdo veprim ka dy faktorë të cilët ndihmojnë njëri tjetrin për të rezultuar një veprim. Njëri faktor është ai moral, pra është vullneti i cili përcakton veprën (pushteti legjislativ) dhe faktori tjetër është ai fizik, dhe ai është forca që ekzekuton (forca ekzekutive). Ruso në mënyrë figurative e përshkruan në këtë mënyrë: në qoftë se një i paralizuar dëshiron të vrapojë, ndërsa një njeri i lëvizshëm këtë nuk e dëshiron, që të dy do të ngelin në vend. Organi politik ka fuqi të njëjta lëvizëse, por gjithashtu, dallojmë forcën (forca ekzekutive) dhe vullnetin (forca legjislative).

Në suaza të kompetencës së pushtetit ekzekutiv, Qeveria e RM-së:

- përcakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe të akteve të tjera të Kuvendit dhe është përgjegjëse për implementimin e tyre;
- sjell rregulla dhe akte të tjera për zbatimin e ligjeve.

Por, kjo kompetencë e Qeverisë për t'i ekzekutuar aktet e Kuvendit përfshin vetëm një pjesë të autorizimeve të saja. Më domethënëse është e drejta e Qeverisë për ta krijuar politikën, përmes propozimit të akteve dhe rregullativave që sjell Kuvendi, si dhe autorizimet të cilat i ka në veprimtarinë normative të Kuvendit.

2. *Në kuadër të kompetencës normative të Kuvendit,* Qeveria e RM-së i propozon aktet vijuese të cilat i sjell Kuvendi i RM-së:

- propozon ligje, buxhetin republikan dhe akte të tjera që i sjell Kuvendi;
- propozon planin hapësinor të Republikës.
- propozon vendime për rezervat e Republikës.

Në praktikë, Qeveria paraqitet si bartës kryesor i iniciativës legislative në Kuvend. Por autorizimet e Qeverisë në kompetencën normative nuk shteren vetëm me autorizimet e saja që t'i propozojë Kuvendit sjelljen e akteve të caktuara. Qeveria e RM-së, gjithashtu, është e autorizuar të japë *mendime për propozimligjet dhe për aktet e tjera* të cilat Kuvendit i ofrojnë propozues të tjerë të autorizuar. Sipas rregullores për veprimtarinë e Qeverisë së RM-së, kur Kuvendi do të kërkojë mendim nga Qeveria për ndonjë material, propozim për sjelljen e ligjit, projekt, përkatësisht propozimligj, rregullativë tjetër ose akt të përgjithshëm, që nuk e ka propozuar Qeveria, ajo e vlerëson në seancë para shqyrtimit të tij në Kuvend dhe mendimin e saj me shkrim ia përcjell Kuvendit, kurse si përjashtim Qeveria mund të autorizojë një përfaqësues të saj për ta paraqitur mendimin e Qeverisë në seancën e Kuvendit.

3. Qeveria e RM-së ka autorizime të rëndësishme edhe në suaza të *udhëheqjes së politikës së jashtme*. Në këtë fushë Qeveria:

- merr vendim për njohjen e shteteve dhe qeverive;
- vendos për marrëdhënie diplomatike dhe konzullare me shtetet e tjera;
- sjell vendime për hapjen e përfaqësive diplomatike – konzullare jashtë shtetit;
- propozon emërimin e ambasadorëve dhe të përfaqësuesve të RM-së në vende të huaja dhe emëron kryetarë të përfaqësive konzullare.

4. Qeveria e RM-së ka edhe disa *autorizime të tjera*, mes tjerash edhe kompetencën që:

- përcakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për veprimtarinë e minsitrive dhe organave të tjera të administratës, të drejtojnë dhe të kryejnë mbikqyrjen mbi veprimtarinë e tyre;
- propozon prokurorin publik;
- kryen emërimin dhe shkarkimin e bartësve të funksioneve të tjera publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- ushtron funksione të tjera të parashikuara me Kushtetut dhe me ligj.

Për kryerjen e autorizimeve Qeveria sjell rregulla, vendime, udhëzime, programe, aktvendime dhe përfundime.

4. Zgjedhja dhe përgjegjësia e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

4.1. Zgjedhja e Qeverisë

Qeveria e RM-së zgjidhet nga ana e Kuvendit. Procedura e zgjedhjes së Qeverisë fillon me caktimin e mandatit për përbërjen e Qeverisë. Presidenti i RM-së është i detyruar që në afat prej 10 ditësh nga konstituimi i Kuvendit, mandatin për përbërjen e Qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë, përkatësisht partive që kanë shumicën në Kuvend. Do të thotë, në ushtrimin e këtij autorizimi presidenti i RM-së nuk mbështetet në vullnetin e tij, por patjetër të përcaktojë për mandatar një

kandidat partie, përkatësisht partitë që kanë shumicën në Kuvend. Ky kufizim i kryetarit të shtetit, i cili si zakonisht në vendet e tjera është rregulluar me konventa kushtetuese ose del nga nevoja që qeveria ta gëzojë besimin e shumicës në parlament, në Kushtetutën e RM-së është shprehimisht e formuluar. Gjatë zbatimit të kësaj dispozite duhet krijuar një praktik që presidenti i Republikës t'ia besojë mandatin për përbërjen e Qeverisë kandidatit të partisë e cila ka shumicën, të cilin ajo vetë do ta caktojë. Si zakonisht në të drejtën e krahasuar kushtetuese mandati për përbërjen e qeverisë i besohet liderit të partisë i cili ka shumicën në parlament, por ekzistojnë edhe raste kur mandati i besohet personit të cilin partia do ta emërojë për mandatar të ardhshëm. I tillë ka qenë rasti me Gjermaninë, kur në zgjedhjet e vitit 1998 fushatën e socialdemokratëve e udhëhiqte G. Shreder i cili qysh në kohën e vijimit të fushatës ishte caktuar nga partia e tij si kandidat për kryeminitër të ardhshëm edhe pse ai nuk ishte kryetar i partisë.

Mandatari, në afat prej 20 ditësh nga dita e besimit të mandatit, Kuvendit i dorëzon programin dhe propozon përbërjen e Qeverisë.

Qeverinë, në bazë të propozimit të mandatit dhe në bazë të programit, e zgjedh Kuvendi me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Pra, mandatarin për përbërjen e Qeverisë, gjatë propozimit të ministrave është i kufizuar me pëlqimin e Kuvendit dhe duhet të ketë kujdes që kandidatët për ministra të jenë të pranueshëm nga deputetët në kuvend.

Kufizimi kryetarit të Qeverisë së RM-së në lidhje me zgjedhjen ose shkarkimin e anëtarëve të Qeverisë është shumë i potencuar për faktin që ai personalisht nuk mund të shkarkojë anëtar të caktuar të Qeverisë, por mund të sjell vetëm propozimin për shkarkim për të cilën vendos Kuvendi në mbledhjen e parë të ardhshme. Në qoftë se kryetari i Qeverisë propozon shkarkimin e më shumë se një të tretës së anëtarëve të Qeverisë nga *përbërja fillestare*, Kuvendi vendos si për zgjedhjen e Qeverisë së re. Vendosja e këtillë e marrëdhënieve ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë mund të çojë deri te prishja e unitetit në Qeveri dhe dobësimin e rolit të kryetarit të Qeverisë, pasi që teoretikisht dhe me kushtetutë ekziston mundësia që Kuvendi t'i kundërvihet propozimit të kryetarit të Qeverisë që të përjashtojë anëtarë të caktuar nga puna e të cilëve nuk është i kënaqur.

4.2. Kontrolli parlamentar dhe përgjegjësia politike e Qeverisë së RM-së para Kuvendit të RM-së.

Një ndër karakteristikat themelore të sistemit parlamentar paraqet të drejtën e parlamentit të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm mbi Qeverinë, të shtrojë pyetje, interpelancë, të formojë komisione të përhershme për përcjelljen e veprimtarisë së Qeverisë, të formojë komisione anketuese për të provuar përgjegjësinë e ministrave dhe të ngjashme. Ky quhet kontroll parlamentar, me që e ushtron parlamenti dhe atë me forma plenare me komisionet e tij dhe kjo shpesh sjell deri te përgjegjësia para parlamentit. Efekti i tij nuk mbaron me aktin e

përgjegjës, por ajo ka efekt parandalues, për shkak se stimulon subjektet mbi të cilat ushtrohet kontrolli që me kujdes dhe në mënyrë të ndërgjegjshme t'i kryejnë detyrat që dalin nga puna e tyre.

Kontrolli parlamentar ka të bëjë edhe me ligjshmërinë dhe me rregullsinë e veprimtarisë. Fjala kontroll ka më shumë kuptime. Por kur përdoret nga aspekti i të drejtës kushtetuese dhe parlamentare, kontrolli ngërthen disa elemente dhe atë:

- elementin informues – evidentohet gjendja faktike;
- elementin vlerësues – vlerësohen rezultatet nga aktiviteti i subjektit që i nënshtrohet kontrollit parlamentar;
- ndërmarrjen e masave adekuate – sanksioneve varësisht nga gjendja e konstatuar.

Kontrolli është i lidhur ngushtë me përgjegjësinë. Kur do të konstatohen parregullësi në punën e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit parlamentar, kjo paraqet shkas për ngritjen e çështjes së përgjegjësive politike.

Mjeti kryesor përmes së cilit parlamenti ushtron kontroll mbi veprimtarinë e Qeverisë janë pyetjet e deputetëve drejtuar ministrave. Çdo deputetë ka të drejtë t'i parashtrijë pyetje kryeministrit dhe ministrave në kohën e rezervuar për pyetje, për të cilat ato janë të detyruar parimisht t'u përgjigjen, me kusht që dhënia e përgjigjeve të mos jetë në kundërshtim me interesin publik, gjë që rrallë ndodh. Pas pyetjeve të deputetëve nuk hapet debat dhe ato nuk kanë sanksione të drejtpërdrejta politike, por ato janë shumë të rëndësishme, duke pasur parasysh se i mundësojnë opozitës që „ të prekë pikat e dobëta ” të Qeverisë dhe me ato ta njoftojë opinionin publik.

Në Republikën e Maqedinisë, në rregullimin kushtetues të kësaj çështjeje në marrëdhëniet ndërmjet pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv paraqiten deformime në lidhje me zgjidhjet në sistemet klasike parlamentare dhe të përziera. Sipas Kushtetutës, Qeveria dhe çdo anëtar i saj për punën e tyre përgjigjen para Kuvendit. Kontrollin mbi veprimtarinë e Qeverisë, deputetët e ushtrojnë përmes pyetjeve të deputetëve dhe interpelancës. Çdo deputet mund të parashtrijë pyetje gojarisht ose me shkrim, ndërsa Qeveria përgjigjet për pyetjet e parashtuara.

Interpelancë mund të paraqesin më së paku 5 deputetë edhe atë për punën e çdo bartësi të funksionit publik, për veprimtarinë e Qeverisë dhe për çdo anëtarë individualisht, si dhe për çështjet nga veprimtaria e organeve shtetërore. Gjatë interpelancës, pas marrjes së përgjigjes, hapet debat që përfundon me votim i cili shpreh vullnetin e Kuvendit për sqarimet e marra nga Qeveria. Mungesa e një kënaqësie të tillë mund të paraqesë shkas për ngritjen e përgjegjësive politike dhe dorëheqjen e Qeverisë, por pakënaqësia e shprehur në fund të seancës parlamentare në vetvete nuk ka pasoja juridike, në kuptimin e shkarkimit të bartësit të funksionit publik.

Kushtetuta në nenin 92 paragrafi 1 përcakton se Qeveria dhe çdo anëtar i saj për punën e tij përgjigjet para Kuvendit, por në tekstin vijues është përcaktuar se Kuvendi mund të votojë mocion mosbesimi ndaj Qeverisë. Duke rregulluar në këtë mënyrë përgjegjësinë mund të konkludohet se megjithëatë Kushtetuta e RM-së mundëson vetëm paraqitjen e mocionit për besueshmërinë e të gjithë Qeverisë. Çështjen e mocionit të votëbesimit të Qeverisë mund ta parashtrojnë më së paku 20 deputetë, por mundet edhe vetë Qeveria ta parashtrojë këtë pyetje. Kushtetuta përcakton se votimi për besueshmërinë e Qeverisë kryhet *me kalimin e tri ditëve* nga dita e parashtrimit të çështjes së votëbesimit. Ky afat duhet t'i japë mundësi Qeverisë që të konsultohet dhe të lë hapësirë për qetësimin e “pasionëve”, dhe deputetët të votojnë me “koka të ftohta”. Keq interpretimi i kësaj dispozite çoi në shndërrimin e votimit në një “ballo të lagatërve” që zhvillohet në mesnatë në ora 24, kur skadon dita e tretë nga dita e paraqitjes së propozimit. Një interpretim i tillë do të ishte në përputhje vetëm me dispozitën sipas së cilës votimi do të kryhej *me skadimin e ditës së tretë* nga dita e paraqitjes së mocionit për votëbesimin.

Vendimi për votimin e mocionit të mosbesimit, sipas Kushtetutës, sillet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Jopreciziteti terminologjik i nenit 92 të Kushtetutës, që operon me termat “çështja e votëbesimit” dhe “votimi i mosbesimit”, çoi në interpretime të ndryshme dhe në inkonsekuenca gjatë formulimit të çështjes për të cilën votuan deputetët. Gjithashtu, Kushtetuta nuk përmba dispozitë për mbajtjen e debatit për çështjen e votëbesimit. Në vitin 1993 të paraqitjes së mocionit të mosbesimit, u institucionalizua praktika që debati të fillojë ditën e tretë pas paraqitjes së mocionit për votëbesim, pas kalimit të këtij afati votohej. Praktika e tillë çoi në shkurtimin e mundësisë që deputetët të shprehin mendimin e tyre mbi një pyetje kaq kruciale. Mundësinë që të dalë i fundit në foltoren e kuvendit, drejtëpërdrejt para votimit, e ka kryetari i Qeverisë.

Në qoftë se Qeverisë i votohet mosbesimi, ajo është e detyruar të japë dorëheqje. Ajo nuk ka mundësi, si në të shumtën e sistemeve parlamentare dhe të përziera, të zgjedhë midis dy opcioneve: të japë dorëheqje ose të kërkojë shpërndarjen e Kuvendit. Mënyrat e tjera të ndërprerjes së mandatit të Qeverisë janë: me shfrytëzimin e të drejtës për të dhënë dorëheqje, me dorëheqjen e kryetarit të Qeverisë, vdekjen e tij, pamundësia e përhershme për ushtrimin e funksionit dhe me shpërndarjen e Kuvendit. Por, Qeveria për të cilën është votuar mosbesimi, që ka dhënë dorëheqje ose së cilës i është ndërprerë mandati për arsye të shpërndarjes së Kuvendit, ngel në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

Në qoftë se Qeveria fiton besimin e shumicës së Kuvendit, nuk mund të paraqitet çështja e mocionit të votëbesimit para kalimit të afatit prej 90 ditësh nga dita e votimit të fundit për votëbesim, vetëm në rastet në qoftë se mocionin për votëbesimin e paraqet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

E gjithë kjo procedurë e paraqitjes së mocionit për votëbesimin e Qeverisë tregon qartë se Qeveria është e varur nga Kuvendi. Qeveria nuk mund të mbijetojë në qoftë se mungon votëbesimi i Kuvendit.

5. Marrëdhëniet ndërmjet kryetarit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Një ndër pyetjet më të rëndësishme që shtrohet në vendet ku ekziston pushtetit ekzekutiv dual (biqefal) – pushteti ekzekutiv që është besuar dy organeve: kryetarit të shtetit dhe qeverisë, është se si janë marrëdhëniet ndërmjet kryetarit të Republikës dhe Qeverisë: hierarkik ose horizontal. Marrëdhëniet kushtetuese dhe praktikës në Republikën e Maqedonisë der tani i përgjigjet varianti i dytë. Por, si funksionon, kjo në fusha të caktuara ku duhet të vepronë që të dy segmentet e pushtetit ekzekutiv. Për shembull, në fushën e mbrojtjes. Ky është një territor të cilin shfaqet e shteteve në sistemet e përziera “ instiktivisht ” e përvetësojnë, duke i kujtuar fushat “ e rezervuara ” të presidentit francezë: mbrojtjen dhe politikën e jashtme.

Pyetja se kush e ka pushtetin suprem mbi forcat e armatosura është pyetje ku përgjigja e parë do të ishte se kryetari i shtetit është komandanti suprem i forcave të armatosura. Mirpo problemi bëhet më i vështirë kur kihet parasysh se autorizime në fushën e mbrojtjes nuk ka vetëm kryetari i shtetit, por edhe Qeveria edhe Ministria e mbrojtjes. Problemet mund të stërzmadhohen po të kihet parasysh fakti që kryetari i Republikës së Maqedonisë nuk ka asnjëfarë autorizimesh në zgjidhjen e ministrit të mbrojtjes.

Ligji për mbrojtjen, i sjellë në vitin 1992, ka dhënë kahe për zgjidhjen e problemeve eventuale që mund të lindin mbi ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara në këtë fushë, në mënyrë taksative duke numëruar autorizimet e kryetarit të Republikës, Qeverisë dhe Ministrisë së mbrojtjes. Për këtë arsye, në udhëheqjen me mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë nuk kanë dalë situata konfliktuoze, gjë që nuk ishte edhe në lëmin e dytë “ të rezervuar ” për kryetarin e shtetit – marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në vitin 1991 në nenin 119 parashikon që marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë i lidh kryetari i RM-së. Marrëveshje ndërkombëtare mund të lidhë edhe Qeveria e RM-së kur kjo është e përcaktuar me ligj. Fushat në të cilat Qeveria lidh marrëveshje ndërkombëtare është definuar në Ligjin për lidhjen, ratifikimin dhe implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra bëhet fjalë për kompetenca të ndara.

Nevoja për bashkëpunimin midis kryetarit dhe Qeverisë, në fushën e politikës së jashtme del nga fakti se marrëveshjet ndërkombëtare i ratifikon Kuvendi, ndërsa Qeveria është ajo që në çdo moment që nga ekzistimi i saj, ka shumicën parlamentare. Kjo kompetencë e Kuvendit të RM-së detyron kryetarin e shtetit që t'i përshtatë qëndrimet e tij në politikën e jashtme me qëndrimet e Qeverisë dhe t'i bëjë të pranueshme për Kuvendin.

Pajtueshmëria ndërmjet kryetarit dhe Qeverisë është e nevojshme edhe gjatë emërimit të ambasadorëve dhe të përfaqësuesve të RM-së jashtë vendit, që e kryen kryetari i Republikës, por sipas propozimit të Qeverisë.

Në Republikën e Maqedonisë konfliktet e para midis kryetarit të shtetit dhe Qeverisë në periudhën e kohabitacionit (periudhë kur Qeveria është e përbërë nga një parti politike ose koalicion, ndërsa kryetari i shtetit është nga partia që është në opozitë në Kuvend ose jashtë tij) kanë lindur në fushën e politikës së jashtme. Të gjithë aktorët lëvizin brenda suazave të të drejtave kushtetuese të tyre. Presidenti i Republikës së Maqedonisë është i autorizuar për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare në emër të RM-së. Kuvendi i RM-së bënë ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Qeveria e Republikës së Maqedonisë vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive; vendos marrëdhënie diplomatike dhe konzulare me shtete të tjera dhe sjell vendime për të hapur përfaqësi diplomatike e konzulare në vende të huaja. Presidenti i Republikës pranon letrat kredenciale dhe të largimit të përfaqësuesve të huaj diplomatikë. E gjithë kjo është e shkruar në Kushtetutë dhe asnjë organ nuk shkeli asnjë nga këto dispozita kushtetuese. Megjithatë, situata konfliktuale ndodhi: në skenën ndërkombëtare Republika e Maqedonisë dërgoi mesazhe tejet të kundërta.

Çka mund të përfundojmë për marrëdhëniet presidenti i RM-së – Qeveria e RM-së? Dispozitat kushtetuese gjithmonë janë pika fillestare e sugjerimit të sqarimit të rolit të institucioneve. Ato flasin për ekzistencën për autorizime efektive të caktuara të presidentit të RM-së, ku Maqedonia radhitet në vendet me sisteme të përziera. Megjithatë, roli i kryetarit të shtetit është më i thjeshtë se roli i kryetarëve të vendeve me sisteme të ashtuquajtura gjysmë presidenciale. Marrëdhëniet e tij me Qeverinë, si segment i dytë i pushtetit ekzekutiv, janë të ndërtuara mbi baza horizontale. Nuk mund të flitet për ndarje hierarkike të këtyre dy organeve. Dispozitat kushtetuese japin bazë për funksionimin e këtyre dy organeve si dyshe, por, dispozitat kushtetuese janë vetëm pika fillestare në analizën e rolit të organeve shtetërore në sistemit politik. Marrëdhëniet e tyre të mirëfillta kushtëzohen edhe nga shumë faktorë të tjerë që karakterizojnë një periudhë konkrete të funksionimit të tyre. Praktika është test për vlerat dhe mangësitë e rregullimit kushtetues të organeve shtetërore. Kohabitacioni, si një gjendje e funksionimit të dy opsioneve të ndryshme politike në kuadër të pushtetit ekzekutiv në një vend, përkundër anës së mirë të saj-vendosja “ e frenave dhe baraspeshës ” dhe në kuadër të vet pushtetit ekzekutiv, bart në vete rezikshmërinë potenciale nga jostabiliteti dhe joefikasiteti që del në sipërfaqe përderisa nuk ekziston konsensus rreth çështjeve të caktuara në fushat ku kanë autorizime edhe kryetari i shtetit edhe Qeveria.